

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

**ASC-09-0103**

Në padinë e

*Paditësi/Aplikuesi/Ankuesi*

Fshati Preoc, Prishtinë

I përfaqësuar [REDACTED], avokat nga Prishtina

kundër

**1.** [REDACTED]  
Fushë Kosovë

**2. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit**

*Të Paditurat*

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën kundër aktvendimit të Gjyqtarit Kryesues të Trupit Gjykues të datës 19 nëntor 2009, SCC-08-0262, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 gusht 2010 lëshon këtë

## A K T V E N D I M

**1. Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.**

**2. Ankuesi obligohet t'i paguaj taksat gjyqësore në vlerë prej 60 eurosh për procedurën ankimore në Dhomën e Posacme.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike:**

Gjyqtari Kryesues i Trupit Gjykues me aktvendimin SCC-08-0262 të datës 19 nëntor 2009 e refuzoi kërkesën e Aplikuesit për asistencë në përkthim dhe lirim nga pagesa e taksave gjyqësore. Aktvendimi thotë se gjendja financiare e parashtruesit të kërkesës nuk mund të shqyrtohet sepse ai nuk ka paraqitur asnjë dokument mbi gjendjen e tij financiare të paraparë me nenin 25.8 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut (UA) 2008/6 dhe nenit 173 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Më 10 dhjetor 2009, Aplikuesi (më vonë Ankuesi) ushtroi parashtresë në lidhje aktvendimin e përmendur më lartë. Ai përfaqësohet nga avokati.

Më 19 janar 2010, Kolegji i Ankesave e urdhëroi Ankuesin të sqarojë nëse parashtresa e ushtruar në DHPGJS më 10 dhjetor 2009 është ankesë kundër aktvendimit të Trupit Gjykues për refuzimin e kërkesës për asistencë në përkthim dhe lirim nga pagesa e taksave gjyqësore, të dorëzojë kopjen e aktvendimit kundër të cilil është paraqitur ankesa dhe kopjen e autorizimit.

Më 22 shkurt 2010, Ankuesi pjesërisht e përmbushi urdhrin. Ankuesi sqaroi se ai ankohet kundër aktvendimit të Gjyqtarit Kryesues me të cilin iu refuzua kërkesa për asistencë në përkthim dhe lirim nga taksat gjyqësore. Megjithatë, Ankuesi nuk e paraqiti kopjen e aktvendimit kundër të cilil është bërë ankesa dhe as autorizimin e vërtetuar nga autoritetet kompetente.

### **Arsyetimi Ligjor:**

Ankesa është e papranueshme.

Neni 61.4 i UA-s- së UNMIK-ut 2008/6 përcakton se me pranimin e ankesës, DHPGJS-ja do ta shqyrtojë atë nëse është në përputhje me kërkesat e UA-së. Nëse DHPGJS-ja vendos se ankesa nuk i plotëson këto kërkesa, do ta urdhërojë ankuesin që të plotësojë ankesën sipas urdhrit dhe brenda periudhës së arsyeshme; nëse kjo nuk bëhet, ankesa duhet të refuzohet.

### III

Më tepër, neni 60.2 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 thotë se aktvendimi i Trupit Gjyques kundër të cilit paraqitet ankesa duhet t'i bashkëngjitet ankesës.

Neni 24.4 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 thotë se DHPGJS-ja mund të kërkojë të dorëzohet një kopje e vërtetuar e autorizimit.

Ankuesi nuk e dorëzoi as kopjen e aktvendimit kundër të cilin është ushtruar ankesa dhe as kopjen e vërtetuar të autorizimit. Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

#### *Taksat gjyqësore*

Në bazë të nenit 57.2 të UA UNMIK-ut 2008/6 Dhoma e Posaçme ka nxjerrë Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore, që janë në fuqi që nga data 10 mars 2010.

Aty thuhet si vijon:

'Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, lidhur me "Tarifat e Taksave Gjyqësore" – me specifikimet e mëposhtme – shpallet të jetë i aplikueshëm për procedurat gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri te neni 10.23 janë të aplikueshëm – mutatis mutandis – për procedurën ankimore para Trupit Gjyques dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, neni 10.11 është i aplikueshëm edhe për procedurën që drejton ankimin kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të Trupit Gjyques.

(...)

Këto Rregulla Plotësuese Procedurale kanë hyrë në fuqi më 10 mars 2010 dhe vlejnë deri më 31 dhjetor 2010.'

Taksat gjyqësore në të dyja shkallët përbëhen, në njëren anë nga një taksë për ushtrimin e parashtresës(ave), në anën tjetër nga një taksë për lëshimin e (një) aktvendimi(eve).

Pasi që aktvendimi në shkallën e parë është lëshuar para ditës së hyrjes në fuqi të rregullave të përmendura më lartë, vetëm taksat gjyqësore të procedurës ankimore do të trajtohen këtu:

Shuma e taksës për ushtrimin e ankesës siç rregullohet me nenin 10.11 të Urdhëresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ") është 30,-- Euro.

Neni 10.15 ADJ përcakton se për aktvendimet për hedhjen e padive (si të papranueshme) duhet të paguhet vetëm gjysma e taksës të rregulluar në nenin 10.1 ADJ (që parimisht i bazon taksat gjyqësore në vlerën e padisë), deri në shumën maksimale prej 30,-- Euro. Kjo vlen edhe për aktvendimet në shkallën e dytë (neni 10.21 ADJ i referohet neneve 10.12 deri 10.18 ADJ). Neni 10.15 në lidhje me nenin 10.21 përfshin aktvendimet në shkallën e dytë që hedhin poshtë ankesat si të papranueshme, si dhe aktvendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve të shkallës së parë që nuk i prekin meritat e lëndës.

Përveç kur vlera e padisë dëshmohet të jetë më e vogël (në shkallën e parë nga paditësi, në shkallën e dytë nga ankuesi), sipas nenit 10.1 në lidhje me nenet 10.15 dhe 10.21, taksa gjyqësore është 30,-- Euro.

Në lëndën në fjalë, as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë nuk janë bërë deklarimet për vlerën e padisë. Prandaj, taksa gjyqësore për aktvendimin në shkallën e dytë është përcaktuar 30,-- Euro.

Si rrjedhojë, taksat gjyqësore në vijim do të aplikohen përfundimisht për procedurën ankimore:

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.11      30 Euro  
 (ushtrimi i ankesës)

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15      30 Euro  
lidhur me 10.21 dhe 10.1 (aktvendimi  
në shkallën e dytë)  
Gjithsej    60 Euro

Këto taksa gjyqësore do të barten nga Ankuesi.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it      nënshkruar  
Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it      nënshkruar  
Eija –Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it      nënshkruar  
Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it      nënshkruar